



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KRUJË

Nr. _____ Prot

Krujë më ____/____/2020

SPECIFIKIME TEKNIKE

OBJEKTI: “PRISHJE DHE TRANSPORT MBETURINASH I OBJEKTEVE TË PABANUESHME TË DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019 NË BASHKINË KRUJË”.

KRUJË 2020

KAPITULLI 1

TE PERGJITHSHME

TABELA E PERMBAJTJES

- 1.1 TE PERGJITHESHME
- 1.2 ZEVENDESIMET
- 1.3 DOKUMENTAT DHE VIZATIMET
- 1.4 KOSTOT PER MOBILIZIM DHE PUNIMET E PERKOHESHME
- 1.5 HYRJA NE SHESH
- 1.6 FURNIZIMI ME UJE
- 1.7 PIKETIMI I PUNIMEVE
- 1.8 FOTOGRAFIMI I SHESHIT
- 1.9 BASHEPUNIME NE SHESH
- 1.10 MBROJTJA E PUNIMEVE DHE E PUBLIKUT
- 1.11 MBROJTJA E AMBIENTIT
- 1.12 TRANSPORTI DHE MAGAZINIMI I MATERIALEVE
- 1.13 SHESHI PER MAGAZINAT DHE ZYRAT
- 1.14 DOKUMENTIMI I VIZATIMEVE
- 1.15 PASTRIMI PERFUNDIMTAR I SHESHIT
- 1.16 SPECIFIKIMET E CMIMEVE SIPAS ZERAVE TE PREVENTIVIT.

1.1 Te pergjithshmet

Paragrafet ne kete kapitull jane plotesuese te detajeve te dhena ne kushtet e kontrates

1.2.Zevendesimet

Zevendesimi i zërave të punimeve (apo i objektit për prishje) te specifikuara ne dokumentin e kontrates do te behen vetem me aprovimin e Mbikeqyresit te Punimeve dhe me miratimin e titullarit AP.

Qe kjo te merret ne konsiderate ,kerkesa per zevendesim do te shoqerohet me nje dokument kërkesë për ndryshime zërash(apo i objektit për prishje).

1.3 Dokumentat dhe vizatimet

Sipermarresi do te verifikojte te gjitha dimencionet,sasite dhe detajet te treguara ne vizatimet,grafiket ose te dhena te tjera dhe punedhenesi nuk do te mbaje pergjegjesi per ndonje mangesi ose mosperputhje te gjetur ne to.Mos zbulimi ose korigjimi i gabimeve ose mosperputhjeve nuk do ta lehtesojne sipermarresin nga pergjegjesia per pune te pa kenaqeshme.Sipermarresi do te marre persiper te gjitha pergjegjesine per berjen e llogaritjeve te madhesive ,llojeve dhe sasive te zerave te perfshira ne punen qe duhet bere sipas kontrates.Ai nuk do te lejohet te kete avantazhe nga ndonje gabim ose mosperputhje ,ndersa nje udhezim i plote do te jepet nga punedhenesi nese gabime te tilla ose mosperputhje do te zbulohen.

1.4 Kostot per mobilizim dhe punimet e perkoheshme

Do te kihet parasys qe sipermarresit nuk do ti behet asnje pagese mbi cmimet njesi te kuotuar per kostot e mobilizimit,d.m.th per sigurine e transportit,driten,energji,veprat dhe paisjet, rrugeve te hyrjes ,te komoditeteve sanitare ,heqjen e mbeturinave(pengesave rrugore, jo ato të parashikuar në kontratë), punen,furnizimin me uje,mbrojtjen kundra zjarrit,rojet,rrjetin telefonik si dhe struktura te tjera te perkoheshme ,paisje dhe material,ose per kujdesin mjekesor dhe mbrojtjen e shendetit,ose patrullat dhe rojet ose per ndonje sherbim tjetër,lehtesi ,gjera ose material te nevojshme ose qe kerkohen per zbatimin e punimeve ne perputhje me ate qe eshte parashikuar ne kontrate.

1.5 Hyrja ne shesh

Sipermarresi duhet te organizoje punen per ndertimin ,mirembajtjen dhe me pas te spositoje dhe ta rivendose cdo rruge hyrje qe do te duhet ne lidhje me zbatimin e punimeve.C'vendosja do te perfshije pershtatjen e zones me c'do rruge hyrje dhe se paku me shkalle sigurie,qendrushmerie dhe te kullimit te ujerave siperfaqesore te njejte me ate qe ekzistonte perpara se sipermarresi te hynte ne shesh.

1.6 Furnizimi me uje

Uji qe nevojitet per zbatimin e kontratës do te merret nga rrjeti kryesor nepermjet nje matesi ne piken me te afert te mundeshme.Sipermarresi do te shtrije rrjetin e vet te perkohshem te tubacioneve.Lidhjet me rrjetin kryesor dhe kostot do te paguhen nga sipermarresi.Ne rastet kur nuk ka mundesi lidhje me rrjetin kryesor sipermarresi duhet te beje vete perpjekjet per furnizimin me uje higjenikisht te paster dhe te pijshem per punetoret dhe punimet.

1.7 Piketimi i punimeve(azhornimi topografik sipas koordinatave të objekteve qe prishe)

Sipermarresi me shpenzimet e tij duhet te beje azhornimin e objekteve qe prishen sic kerkohet,ne perputhje me informacionin baze te punedhenesit dhe do te jete pergjegjesi i vetem per perpikemerine.

Sipermarresi do te jete pergjegjes per te kontrolluar dhe verifikuar informacionin baze qe eshte dhene,dhe ne asnje menyre nuk do te lehtesohet nga pergjegjesia e tij nese nje informacion i tille eshte i manget,jo autentik ose jo korrekt.Ai nderkohe do te jete subjekti qe do te kontrollohet dhe rishikohet nga punedhenesi,dhe ne asnje rast nuk i jepet e drejta te beje ndryshimet ne vizatimet e kontrates,per asnje lloj kompensimi per korigjimet e gabimeve ose te mangesive.Sipermarresi do te furnizojte dhe mirmbaje me shpenzimet e tij,rrethimin dhe materiale te tjera te tilla dhe te jape asistenca nepermjet nje stafi te kualifikuar sic mund te kerkohet nga punedhenesi per kontrollin e azhornimit të objekteve.

Perpara c'do aktiviteti ndertimor (prishje),sipermarresi do te kete linjat e furnizimit me uje dhe energji elektrike te vendosura ne terren,te drejten e kalimit te qarte dhe te sheshuar gati per filimin e prishjeve.C'do pune e bere jashte kufijve te treguar ne vizatime ose te mosmiratuara nga punedhenesi nuk do te paguhet dhe sipermarresi do te mbuloje me shpenzimet e tij germimet shtese gjithmone nen drejtimin e Mbikqyresit te Punimeve.

1.8 Fotografite e sheshit te ndertimit.

Sipermarresi duhet te beje fotografi me ngjyra sipar udhezimit te Mbikqyresit te Punimeve ne vendet e punes per te demonstruar kushtet e sheshit perpara fillimit, progresin gjate punes se prishjes dhe mbas perfundimit te punimeve. Nuk do te behen pagesa per fotografimin e kantjerit te punimeve (prishjeve) pasi keto shpenzime jane parashikuar te mbulohen ne koston administrative te sipermarresit.

1.9 Bashepunime ne shesh

Prishja do te behet ne zona te kufizuara.Sipermarresi duhet te kete kujdes ne:

- Nevojen per te mbajtur sherbimet ekzistuese dhe mundesite e kalimit per banoret dhe tregetaret qe jane ne zone gjate periudhes se ndertimit.
- Prezencen e mundeshme te kontraktoreve te tjere ne zone me te cilet do te kordinohet puna.

E gjithë puna do te behet ne nje menyre te tille qe te lejoje hyrjen dhe perballimin e te gjithë paisjeve te mundeshme per ndonje kontraktor tjeter dhe punetoreve te tij,stafin e punedhenesit si dhe te c'do punonjesi qe mund te punesohet ne zbatim dhe ,ose punimet ne zone ose prane saj,per c'do object qe ka lidhe me kontraten ose c'do gje tjeter.

Ne pregaditjen e programit te punes sipermarresi gjate gjithë kohes do te beje llogari te plote dhe do te koeporoje me programin e punes se kontraktoreve te tjere,ne menyre qe te shkaktoje nje minimum interference me ta dhe me publikun.

1.10 Mbrojtja e punes dhe e publikut

Sipermarresi do te marre masa paraprake per mbrojtjen e punetoreve te punesuar

dhe te jetes publike,si dhe te pasurive nen dhe rreth sheshit te ndertimit, sidomos të objekteve ngjitur me objektet që prishen, dhe përgjegjesia e prishjes seyre objekteve do te jete vetem e kontraktorit. Masa e sigurimit paraprak te ligjeve te aplikueshme,kodeve te ndertesave dhe te ndertimit do te respektohen. Makinerite paisjet dhe c’do rrezik do te shikohen ose eliminohen ne perputhje me masat paraprake te sigurimit.

Gjate zbatimit te punimeve sipermarresi me shpenzimet e veta duhet te vendosi dhe mirembaje gjate nates pengesa te tilla dhe drita te cilat do te parandalojne ne menyre efektive aksidentet. Sipermarresi duhet te siguroje pengesa te pershtateshme, shenja me drite te kuqe, ”rrezik”ose “kujdes”dhe vrojtues ne te gjitha vendet ku punimet mund te shkaktojne c’rregullime te trafikut normal ose qe perbejne ne ndonje menyre rrezik per publikun.

1.11 Mbrojtja e ambientit

Sipermarresi me shpenzimet e veta,duhet te ndermarre te gjitha veprimet e mundeshme per te siguruar qe ambienti lokal i sheshit te ruhet dhe qe vijat e ujit ,takat dhe ajri (duke perfshire edhe zhurmat)te jene te pastra nga ndotja per shkak te punimeve te kryera .Mos plotesimi i kesaj klauzole, ne baze te evidentimit nga mbikqyresi i punimeve,mund te coje ne nderprerjen e kontrates.

1.12 Transporti dhe magazinimi i materialeve qe përfitohen nga dezermimi dhe i inerteve

Transporti i cdo materiali nga sipermarresi do te behet me makina te pershtateshme,te cilat kur ngarkohen nuk shkaktojne derdhje dhe e gjithë ngarkesa te jete e siguruar.Ndonje makine qe nuk ploteson kete kerkese ose ndonje nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do te hiqet nga kantjeri.Te gjitha materjalet qe përfitohen nga dezermimi nga sipermarresi duhet te stivohen ose magazinohen ne menyre te pershtateshme per ti mbrojtur nga rreshqitjet,demtimit ,thyerjet,vjedhjet dhe ne dispozicion per tu kontrolluar nga Mbikqyresi i Punimeve ne c’do kohe.

1.13 Sheshi per magazinat dhe zyrat

Sipermarrei duhet te beje me shpenzimet e tij marrjen me qira ose blerjen e nje terreni te mjaftueshem per ngritjen e magazinave me shpenzimet e tij.

1.14Kopjimi i vizatimeve (Vizatimet sic eshte zbatuar)

Sipermarresi duhet te pergadise vizatimet per te gjitha punimet **“sic jane faktikisht te zbatuara”**ne terren.Vizatimet do te behen ne nje standart te ngjashme me ate te vizatimeve te kontrates.

Gjate zbatimit te punimeve ne kantjer sipermarresi do te ruaje te gjithë informacionin e nevojshem per pergaditjen e vizatimeve“ sic eshte zbatuar”.Do te shenoje ne menyre te qarte vizatimet dhe te gjitha dokumentat e tjera te cilat mbulojne punen a vazhdueshme te perfunduar,material i cili do te jete i disponueshem ne c’do kohe gjate zbatimit per Menaxherin e Projektit. Keto vizatime do te azhurnohen ne menyre te vazhdueshme dhe do ti dorezohen Mbikqyresit te Punimeve c’do muaj per aprovim, pasi punimet te kene

perfunduar se bashku me kopjen perfundimtare. Materiali mujor do te dorezohet ne kopje leter.

Vizatimet e riprodhuara do te perfshijne pozicionin dhe shtrirjen e te gjithë konstruksioneve mbajtese te lena gjate germimeve dhe vendosjen ekzakte te te gjitha sherbimeve qe jane ngjeshur gjate ndertimit. Sipermarresi gjithashtu duhet te pergadise seksionet e profilit gjatesor te rishikuar, paisur me shenimet qe tregojne shtresat e tokes qe hase gjate te gjitha punimeve te germimit. Si perfundim kopjet e riprodhuara te **vizatimeve “sic eshte zbatuar”**do ti dorezohen Mbikqyresit te Punimeve per aprovim. Vizatimet **“sic eshte zbatuar”**te aprovuar do te behen prone e punedhenesit.

Nuk do te behen pagesa per berjen e vizatimeve **“sic eshte zbatuar”**dhe manualeve pasi kostoja e tyre eshte parashikuar te mbulohen nga shpenzimet administrative te sipermarresit.

1.15 Pastrimi perfundimtar i zones

Ne perfundim te punes sa here qe eshte e aplikueshme sipermarresi me shpenzimet e tij,duhet te pastroje dhe te heqe nga sheshi te gjitha impjantet ndertimore,materjalet qe kane tepruar,mbeturinat skelerite dhe ndertimet e perkohshme te c’do lloji dhe te lere sheshin e lire dhe veprat te pastra dhe ne kushte te pranueshme. Gjatë gjithë kohes se kryerjes se punimeve, duhet bere lagia e inertevePagesa perfundimtare do te mbahet derisa kjo te realizohet dhe pasi te jepet miratimi nga Mbikqyresi i Punimeve.

SPECIFIKIME TEKNIKE

KAPITULLI 2

PRISHJET

TABELA E PERMBAJTJES

2.1 QELLIMI

2.2 PERCAKTIMET

2.3 TRAJTIMI ,NGJESHJA E ZONAVE TE GERMUARA

2.4 PUNIMI I PRISHJEVE

2.5 PASTRIMI I SHESHIT

2.6 PERSHKRIMI I CMIMIT NJESI PER PRISHJET

2.7 MATJET

2.1 Qellimi

Ky seksion permban percaktimet e pergjithshme dhe kerkesa per punimet e prishjeve mbi dhe nen toke (ne vellim dhe /ose ne shtresa) dhe germimet per strukturat ne kanale perfshire germimin nen uje. Me tej ajo mbulon te gjitha te gjitha punimet qe lidhen me prishjen e objekteve.

2.2 Percaktimet

Percaktimet e meposhteme duhet te aplikohen:

Prishja e strukturave te vecanta te sejcilit objekt, sipas ktz e ligjeve ne fuqi.

2.3 Trajtimi ,ngjeshja e zonave te germuara

- Zonat dhe dheshet ku do kryhen prishjet, ne perfundim duhet te jene te sistemuara me fadrome. te ngjeshura me rrul.

2.4 Punimet e prishjeve

Brenda ketij procesi pune do te perfshihen të gjitha proceset e punes te domasdoshme per prishjen e strukturave shumkateshe, duke filluar nga rrethimi i shesheve respektive, sigurimi i shesheve, masat e sigurimit teknik, skelerite e nevojshme, dhe procesi i prishjes sipas percaktimeve ne preventive, duke filluar nga strukturat e mbuleses (soletat), prishjet e strukturave te betonit e beton armese, prerjet e hekurave qe pengojne ngarkimin e ne mjet, prishjen e themeleve, copetimin e materialit per tab ere te pershtatshmem per ngarkim ne mjet. Ne te gjitha rastet, prishja do te jete e kontrolluar, ne pranine e organeve kompetente sipas legjislacionit ne fuqi.

2.5 Pastrimi i sheshit

Te gjitha sheshet ku do te germohet do te pastrohen nga te gjitha shkurret,bimet,ferrat ,rrenjet e medha,pleherat dhe materiale te tjera siperfaqesore.Te gjitha keto materiale do te spostohen dhe largohen ne menyre qe te jete e pelqyeshme per punedhenesin.Te gjitha pemet dhe shkurret qe jane percaktuar nga punedhenesi qe do te ngelen do te mbrohen dhe ruhen ne menyren e aprovuar.Te gjitha strukturat ekzistuese te identifikuara per tu prishur do te largohen sipas udhezimeve te mbikqyresit te punimeve.Kjo do te perfshije edhe spostimin e themeleve te ndertimeve qe mund te ndeshen.Sipermarresi do te marre te gjitha masat e nevojshme per mbrojtjen e vijave ekzistuese te ujit,rrethimeve dhe sherbimeve qe do te mbeten ne sheshin e ndertimit.Kosto e pastrimit te kantjerit

eshte e detyrueshme te paguhet brenda cmimit njesi per punimet e germimit.

2.6 Pershkrimi i cmimit njesi per germimet

Brenda cmimit njesi do te perfshihen, shpenzimet per ngritjen e kantierit dhe ngrehinave provizore, shpenzimet administrative per azhornimin e punes, shpenzimet per makinerite qe do bejne prishjen e strukturave, shpenzimet per rrethimin dhe lagien e objektit, shpenzimet per copetimin e materialeve e prerjen e hekurave qe pengojne ngarkimin ne mjet, shpenzimet per spostimet dhe grumbullimet e materialeve.

Po ashtu brenda cmimit njesi do te perfshihet dhe shpenzimet e punetorise, stafit teknik, shpenzimet plotesuese dhe fitimi i planifikuar. Nuk do te aplikohet tvsh pasi procesi i rindertimit eshte pa tvsh.

2.7 Matjet

Te gjitha zerat e punimeve do te maten ne volum. Matja e volumit te prishjeve do te bazohet ne dimencionet e marra nga vizatimet, ne te cilat percaktohen permasat e prishjeve. C' do prishje pertej limiteve te percaktuara ne keto vizatime nuk do te paguhet, nese nuk percaktohen me pare me shkrim nga Mbikeqyresi i Punimeve. Megjithate, nese prishjai eshte me pak se volume i llogaritur ne vizatimet do te paguhet volumi faktik i germimeve sipas matjeve faktike.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

KAPITULLI III

NGARKIMI E TRANSPORTI

TABELA EPERMBAJTJES

3.1 TE PERGJITHSHME

3.2 NGARKIMI I INERTEVE

3.3 TRANSPORTIMI I MATERIALEVE

3.4 MBULIMI I CMIMIT NJESI NGARKIMIN DHE TRANSPORTIN E INERTEVE

3.1 Te pergjithshme

Puna e mbuluar nga ky seksion i specifikimeve konsiston ne fumizimin e gjithe kantierit, punen, pajisjet, veglat dhe materialet, dhe kryerjen e te gjitha punimeve, ne lidhje me ngarkimin dhe transportin e mbetjeve inerte, te krijuara si rezultat i prishjes se ndertimeve te shpallura te pabanuesheme dhe te programuara per tu prishur, ne perputhje rigoroze me kete kapitull te specifikimeve dhe projekt

zbatimin.

Ne fillim te Kontrates Sipermarresi duhet te paraqese per miratim tek Mbikeqyresi i Punimeve nje njoftim per metodat duke detajuar, ne lidhje me kerkesat e ketyre Specifikimeve, propozimet e tij per organizimin e aktiviteteve te ngarkimit te mbeturinave ne shesh (teren) dhe transportin e tyre ne piken e caktuar nga bashkia per depozitimine mbetjeve inerte.

Sipermarresi do te punesoje inxhinier te kualifikuar, te specializuar dhe me eksperience, i cili do te jete pergjegjes per kontrollin e zbatimit te kontrates.

3.2 Ngarkimi i materialeve inerte

Pas coptimit dhe grumbullimit te materialeve inerte te krijuara pas prishjeve te objekteve, behet ngarkimi i tyre me eskavator me kove 1m³ dhe me fadroma, ne kamjone te tonazhit te madh, duke respektuar rregullat ne fuqi per tonazhin dhe sasine e ngarkeses.

3.3 Transportimi i materialeve inerte

Pas ngarkimit te materialeve inerte, behet transport ii tyre ne piken e caktuar nga bashkia, duke respektuar rregullat e qarkullimit rrugor. Materiali inert duhet te laget paraprakisht dhe ngarkesat duhen mbuluar, me qellim ruajtjen e ambjentit.

Ne piken e caktuar nga bashkia per depozitimine e materialeve inerte, duhet te caktohet nje specialist i Drejtorise se Sherbimeve ne bashki, me qellim menaxhimin e sistemit te tyre.

3.4 Pershkrimi i cmimit njesi per ngarkimin dhe transportin e mbeturinave

Brenda cmimit njesi do te perfshihen, shpenzimet per ngritjen e kantierit dhe ngrehinave provizore, shpenzimet administrative per azhornimin e punes, shpenzimet per makinerite qe do bejne ngarkimin dhe transportin e mbeturinave inerte, shpenzimet per lagjen e inerteve ne kamion, Po ashtu brenda cmimit njesi do te perfshihet dhe shpenzimet e punetore, stafit teknik, shpenzimet plotesuese dhe fitimi i planifikuar. Nuk do te aplikohet tvsh pasi procesi i rindertimit eshte pa tvsh.